

## **Autoritetet Evropiane paralajmërojnë mbi rreziqet e investimeve në krypto-asete**

Autoritetet Evropiane të Mbikëqyrjes Financiare (Autoriteti Evropian i Bankave - EBA, Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve - ESMA dhe Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale - EIOPA) [kanë publikuar një paralajmërim](#)<sup>1</sup> drejtuar publikut në lidhje me investimet në krypto-asete (tokena digjitalë/monedha virtuale), duke i cilësuar këto produkte me risk të lartë dhe spekulative. Autoritetet theksojnë se këto produkte nuk janë të përshtatshme për konsumatorët jo-profesionistë si instrumente investimi ose si mjet pagesash, si dhe paralajmërojnë publikun të tregohet i kujdesshëm në lidhje me reklamimet e rreme, të cilat premtojnë norma fitimi të shpejta dhe anomalisht të larta.

Linkun për të aksesuar dokumentin e plotë të publikuar nga Autoritetet Evropiane të Mbikëqyrjes Financiare mund ta gjeni më poshtë:

[https://www.eiopa.europa.eu/sites/default/files/publications/other\\_documents/esa\\_2022\\_15\\_joint\\_esas\\_warning\\_on\\_crypto-assets\\_en.pdf](https://www.eiopa.europa.eu/sites/default/files/publications/other_documents/esa_2022_15_joint_esas_warning_on_crypto-assets_en.pdf)

Bazuar në ligjin 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, AMF nuk ka licencuar ose autorizuar aktualisht asnjë subjekt për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes, tregimit dhe ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe monedhave virtuale. Të gjitha shoqëritë që ofrojnë shërbime investimi në monedha virtuale duhet të licencohen dhe të marrin autorizimin përkatës nga autoritetet rregullatore, në zbatim të Ligjit 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, ku parashikohet ndër të tjera edhe mbrojtja e duhur ndaj investitorëve.

Paralajmërimet për investitorët publikon në mënyrë të vazhdueshme edhe Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO), ku AMF aderon që nga viti 1998. Në një seksion të posaçëm në faqen zyrtare, IOSCO pasqyron paralajmërimet e anëtarëve të organizatës, kryesisht në lidhje me rrezikun e investimit përmes kompanive të palicencuara, ku investitorët rezultojnë të jenë të pambrojtur.

[https://www.iosco.org/investor\\_protection/?subsection=investor\\_alerts\\_portal](https://www.iosco.org/investor_protection/?subsection=investor_alerts_portal)

Autoritetet rregullatore tërheqin vëmendjen se përpara ndërmarrjes së një investimi, personat e interesuar duhet të kontrollojnë listën e subjekteve të licencuara që ofrojnë këto shërbime sipas vendeve përkatëse. AMF përditëson në mënyrë të vazhdueshme listën e subjekteve të licencuara sipas tregjeve në mbikëqyrje, e aksesueshme për publikun në faqen zyrtare.

---

<sup>1</sup> ESA: “EU financial regulators warn consumers on the risks of crypto-assets”

[https://www.eiopa.europa.eu/sites/default/files/publications/other\\_documents/esa\\_2022\\_15\\_joint\\_esas\\_warning\\_on\\_crypto-assets\\_en.pdf](https://www.eiopa.europa.eu/sites/default/files/publications/other_documents/esa_2022_15_joint_esas_warning_on_crypto-assets_en.pdf)